



Datë: 02.06.2025
Numër Protokolli: 3791/2025

A.nr.580/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.580/2025, të datës 02.04.2025, të parashtruar nga ankuesi A.K., kundër organit të punësimit-Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike “*masë disiplinore*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 02.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.580/2025, e datës 02.04.2025, e parashtruar nga ankuesi, A.K., ashtu që **shfuqizohet** Vendimi Nr.Prot.1-178/02-KOM, i datës 04.03.2025, i Komisionit Disiplinor, ndërsa lënda kthehet ***në rishqyrtim*** dhe ***rivendosje*** të organi i njëjtë.

II. Obligohet Komisioni Disiplinor në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi, sikurse përcaktohet në piken I të dispozitivit, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, A.K. (në tekstin e mëtejme referuar: *Ankuesi*), më datë 02.04.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.Prot.1-178/02-KOM, të datës 04.03.2025, të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: *Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datës 14.04.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ndërsa kjo e fundit më datë 17.04.2025, ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat referuar çështjes në procedurë.

Kryetari i Këshillit, pas pranimit të kërkesës së Kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjes së Ankesave, me Vendimin me numër VK/2025 dhe numër të protokollit 3198/2025 të datës 15.05.2025, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës së parashtruar nga ankuesi edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoli 2181/2025, të datës 02.04.2025, të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Dokumentin e identifikimit të ankuesit; Kërkesën me numër protokoli 1-1333/12 të datës 04.12.2024; Vendimin me Nr.Prot.1-178/02-KOM, të datës 04.03.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë, të datës 14.04.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 17.04.2025; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit, të datës 23.12.2015 dhe përshkrimin e detyrave të punës; Vendimin me numër protokoli 259 të datës 20.01.2022; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit të datës 29.03.2016 dhe përshkrimin e detyrave të punës; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit të datës 01.10.2019 dhe përshkrimin e detyrave të punës; Ftesat për mbajtjen e seancave disiplinore; Vendimin me numër protokoli 1-1192/02 të datës 13.11.2024; Vendimin me numër protokoli 1-154/02 të datës 21.02.2025; Akt emërimit AE.Nr.38/2024 të datës 26.02.2024; Vendimin me numër protokoli 1-1071/01 të datës 10.10.2024; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit të datës 14.08.2019; Vendimin me numër protokoli 1-1211/01 të datës 14.11.2024; Akt emërimit të datës 31.01.2012; Diplomën me numër 2799 të datës 13.04.2022; Diplomën me numër 233/16 të datës 27.09.2016; Diplomën me numër 7078 të datës 15.10.2020; Vërtetimin e kopjes nga origjinali me LRP nr.4739/2023; Procesverbalin e datës 04.03.2025; Komunikimet elektronike zyrtare (e-mailat) prej 128 faqeve; Formularët e vlerësimit të rezultateve të punës të datës 31.01.2023; 27.02.2024; Dëshmi mbi pushimet e ankuesit për vitet paraprake.

Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka gjetur se ankesa është e bazuar dhe se lënda duhet të kthehet në **ri-shqyrtim** dhe **rivendosje të organi i njëjtë**, sepse:

Kolegji i Këshillit, nga administrimi i shkresave të lëndës konstaton se ankuesi, sipas Ndryshimit dhe plotësimit të aktit të emërimit të datës 01.10.2019, është i punësuar në pozitën e punës *Udhëheqës i Sektorit për Zhvillimin e Zonave Ekonomike* pranë Agjencisë për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA)- Ministrisë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Tutje nga shkresat e lëndës, rrjedh se Drejtori i Drejtoratit për Zhvillim të Sektorit Privat i KIESA-s, në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të ankuesit, me datë 04.12.2024 ka parashtruar kërkesën me numër protokoli 1-1333/12, për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj këtij të fundit, për shkelje të rënda disiplinore, gjegjësisht për shkak të mos përmbushjes së detyrave të punës në afat të caktuar apo përmbushjes pjesërisht dhe me shumë vështirësi jashtë afateve kohore, si dhe për shkak të neglizhencës dhe mosbashkëpunimit me udhëheqësin e tij, ashtu që ka theksuar mbi nëntë (9) shkelje të pretenduara nga i njëjti.

Komisioni Disiplinor i organit përkatës të punësimit, me Vendimin me Nr.Prot.1-24/02-KOM të datës 14.01.2025, fillimisht në mbështetje të nenit 99 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke u bazuar në njoftimin e Njesisë së Burimeve Njerëzore të datës 08.01.2024, lidhur me gjendjen shëndetësore të ankuesit, ka shtyrë afatin për trajtimin e lëndës dhe vendimmarrjes edhe për dyzet e pesë (45) ditë tjera, pas përfundimit të afatit fillestar, ndërsa më datë 04.03.2025, ka nxjerrë Vendimin me Nr.Prot. 1-178/02-Kom, përmes të cilit ka konstatuar se ankuesi me veprimet e tij ka bërë shkelje të rënda disiplinore, gjegjësisht mos respektim i afateve të caktuara për përmbushjen e detyrave të punës dhe rrjedhimisht të njëjtit i shqipton masën disiplinore “*transferimi në pozitë të ngjashme në klasë dhe kategori të njëjtë*”, sikurse përcaktohet me nenin 57 paragrafi 2 nën paragrafi 2.3 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vendimit të lartë theksuar pretendon se nuk ka kryer shkelje të detyrave dhe përgjegjësi në punë.

Kolegji i Këshillit, në kuptim të vendosjes meritorie lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, fillimisht analizoi dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrat Publikë, me theks të veçantë:

- Nenit 55 paragrafi 1: *“Nëpunësja/i civil mban përgjegjësi disiplinore për shkelje të detyrave dhe përgjegjësi, në rastet kur nuk kryen detyrat që i janë dhënë, kur bën zbatim jo të duhur të tyre apo kur gjatë ushtrimit të tyre vepron në kundërshtim me Kushtetutën, ligjet dhe akte të tjera nënligjore në fuqi. Shkelja disiplinore mund të bëhet me veprim apo mosveprim”.*

- Nenit 56, paragrafi 1 dhe 4 me të cilin është përcaktuar se: *“Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësi në punës mund të jenë: 1.1. shkelje të lehta; 1.2. shkelje të rënda. Shkelje të rënda konsiderohen: 4.1. mospërbushja e detyrave të punës; 4.2. neglizhencë e vazhdueshme në përbushje të detyrave të punës; 4.3. mosrespektimi i afateve të caktuara për përbushjen e detyrave të punës; 4.4. moszbatimi i dispozitave ligjore për përbushjen e detyrave funksionale; 4.5. veprimet apo mosveprimet që kanë shkaktuar pasoja; 4.6. shkelja e rregullave të përcaktuara në kodin e etikës; 4.7. sjellje e papërshtatshme që dëmton reputacionin e shërbimit civil; 4.8. vënia në lajthitje e organit publik përmes dhënies së informatave të gabuara ose fshehja e të dhënave zyrtare kur kërkohen për qëllime zyrtare; 4.9. përfitimi apo ofrimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale që ndodhin për shkak të detyrës; 4.10. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vazhdueshme për tri (3) ose më shumë ditë pune; 4.11. përsëritja e shkeljeve të lehta disiplinore dy (2) apo më shumë herë; 4.12. moslajmërimi i shkeljeve të rënda që lidhet me detyrat e punës nga nëpunësja/i civil; dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 4.14. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit dhe dokumenteve të klasifikuara; 4.15. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera narkotike të ndaluara; 4.16. përdorimi i alkoolit në vend të punës ose ardhja e/i dehur në punë; 4.17. keqpërdorimi i detyrës zyrtare lidhur me procedurën e rekrutimit nga anëtarët/ët e komisionit të rekrutimit që janë shërbyes civil; 4.18. ngacmimet në vendin e punës apo gjatë ushtrimit të detyrës, që cenojnë integritetin moral dhe fizik, si dhe ato seksuale; 4.19. diskriminimi mbi baza gjinore, racore dhe të tjera, sipas Ligjit përkatës Kundër Diskriminimit; 4.20. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislationin në fuqi”.*

-Nenit 57 paragrafi 2 : *“Masat disiplinore, të cilat mund të shqiptohen ndaj nëpunës/it civil për shkelje të rënda janë: 2.1. ndalimi nga njëzet për qind (20%) deri në pesëdhjetë (50%) e pagës bazë për një periudhë deri në gjashtë (6) muaj; 2.2. ndalimi i avancimit/emërimit në kategori më të lartë, për një periudhë nga një (1) deri në pesë (5) vite; 2.3. transferimi në pozitë të ngjashme në klasë dhe kategori të njëjtë; 2.4. ulja në pozitë; 2.5. pezullimi nga pozita pa pagesë deri në gjashtë (6) muaj; 2.6. pezullimi nga pozita me ndalim deri në pesëdhjetë për qind (50%) të pagës bazë, deri në një (1) vit; 2.7. largimi nga shërbimi civil”.*

-Nenit 58, paragrafit 2 me të cilin është përcaktuar kompetenca lëndore për shqiptimin e masave disiplinore: *“Masat disiplinore për shkeljet e rënda shqiptohen nga komisioni disiplinor”.*

Rrjedhimisht, bazuar në kuadrin ligjor si me sipër, Kolegji analizoi aktin e kundërshtuar me ankesë, gjegjësisht Vendimin Nr.Prot.1-178/02-Kom të datës 04.03.2025, me të cilin ankuesin Komisioni Disiplinor e ka shpallur përgjegjës për mos respektim të afateve të caktuara për përbushjen e detyrave të punës, duke i shqiptuar masa disiplinore *“transferimi në pozitë të ngjashme në klasë dhe kategori të njëjtë”*, dhe si rrjedhojë Kolegji i Këshillit, konstatoi se i njëjti vendim është i përfshirë në mos konstatim të plotë të gjendjes faktike, ngase me rastin e shpalljes përgjegjës të ankuesit nuk ka përcaktuar apo konstatuar saktësisht se cilën apo cilat nga detyrat e punës nuk i ka përfunduar sipas afateve të caktuara i njëjti, dhe se po ashtu akti administrativ i kontestuar me ankesë, për nga përbajtja dhe arsyetimi nuk ka mbështetje në dispozitat e nenit 48 paragrafit 1 nën paragrafit 2 dhe 3 të Ligjit 05/L-031 të Procedurës së Përgjithshme Administrative, ngase i njëjti nuk ka shpjeguar

qartë situatën faktike dhe nuk ka përshkruar asnjë nga provat të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vendimmarrjes, ashtu që i njëjti akt është në kundërshtim edhe me paragrafin 2 të këtij neni, i cili përcakton se: “2. *Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij*” dhe si i tillë konsiderohet e paligjshme në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për rrjedhojë e njëjti është anuluar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, për sa me sipër dhe duke marr për bazë se respektimi i dispozitave procedurale është njeri ndër parakushtet kryesore për nxjerrjen e një akti administrativ të drejt dhe të ligjshëm, dhe meqenëse, me provat e administruara është vërtetuar se në rrethanat e rastit konkret, akti i kontestuar me ankesë është nxjerr përmes shkeljes së dispozitave procedurale për shkak se nuk ka vërtetuar mjaftueshëm apo fare se për cilën nga detyrat e punës ankuesit i është shqiptuar masa e lartë theksuar disiplinore, Kolegji i Këshillit vendosi që të aprovoj ankesën si të bazuar, të shfuqizoj Vendimin me numër Nr.Prot.1-178/02-Kom të datës 04.03.2025 të Komisionit Disiplinor, dhe çështjen të kthej në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë, gjegjësisht të Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, me detyrimin që ky i fundit në ri procedurë të veproj sipas pikëpamjeve juridike të dhëna si në arsyetim të këtij vendimi, ashtu që duke marrë parasysh se ankuesi për shkak të gjendjes shëndetësore nuk ka mundur të paraqitej në seancën disiplinore apo edhe të deklarohet me shkrim, dhe në kuptim të respektimit të të drejtave të ankuesit sipas akteve ligjore në fuqi, përfshirë këtu, por pa u kufizuar, në të drejtën e tij për tu njoftuar se gjatë seancës disiplinore mund të ndihmohet nga një përfaqësues i sindikatës ku bënë pjesë, nga një përfaqësues ligjor apo nga një përfaqësues i nëpunësve civil të institucionit, dhe të drejtën e dëgjimit, dhe pas konstatimit në mënyrë të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, të nxjerr vendim merititor në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.580/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit A.K.;
- Organit të punësimit: Komisionit Disiplinor dhe Udhëheqëses së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.